



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Nr. Prot. _____
Br. Prot. _____
Prot. No. _____
Data _____
Datum _____
Date _____

Nr. 114q. _____
Broj stranica _____
Nr. pages _____

2-0/DPK
01-845/14
12.03.2014
02
PRISTINE

DATË/A:	11.12.2013
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Rexhep Kadriu – Nënkyetar i Komunës së Gjilanit,
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari ztr. Kadriu

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK-03-599/14), ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; "bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave", (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Lidhur me kërkesën tuaj, në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, për rastin e caktuar, kemi nxjerr këtë :

OPINION :

Nuk ka konflikt interesi në ushtrimin e funksionit tuaj publik si Nënkyetar i Komunës, dhe të qenurit pronar i biznesit privat.

Por, këtu mund të shfaqet konflikt interesi “rast për rast” të cilin ju duhet ta deklaroni me kohë nëse ai paraqitet.

Arsyetim:

Këtu do tu njoftojmë cilat situata konsiderohen konflikt interesi për zyrtarin dhe po ashtu, në bazë të kërkesës tuaj me numër protokoli të AKK-së DPKI-03-599/14, do të përgjigjemi në pyetjen që ju e keni parashtruar në shkresën tuaj të datës 12.02.2014.

Së pari është me rëndësi të citojmë nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përkufizon *çka është konflikti i interesit ?*.

Nga ky përkufizim kuptojmë, pos të tjerash, se; *“konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtëpërdrejta ose të tërrthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”*.

Po ashtu në Nenin 8 të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit janë të përcaktuara detyrimet e zyrtarit të lartë për të shmangur situatat e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Rasti i juaj konkret ka të bëjë më tepër me sqarimin e asaj që quhet e drejta e pronësisë në biznesin privat.

Ligji për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) nuk e parasheh si konflikt interesi faktin nëse Zyrtari i lartë është pronar i ndonjë biznesi privat. Por, natyrisht se ekzistojnë disa kufizime si p.sh. pronari i biznesit privat duke qenë edhe zyrtar i lartë i shtetit, nuk ka të drejtë të bëjë zotërimin aktiv të aksioneve, që do të thotë ai bënë zotërimin pasiv të aksioneve ose pjesës së kapitalit, e që me fjalë tjera do të thotë; pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve të pronësisë, por nuk mund të ushtroj vet asnjë veprim tjetër mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet tjera si administrimi, zotërimi, kryhen nga personi i besuar (personi i autorizuar).

Por, duke qenë se ju keni funksionin e Nënkyetarit të komunës dhe jeni pronar legjitim i biznesit privat “Pro Eng” Sh.p.k., atëherë duhet domosdoshmërisht që ta keni para sysh nenin 13 të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me të gjitha paragrafet e tija, të cilat obligojnë çdo zyrtar të lartë që gjatë ushtrimit të funksionit publik në bazë të njohurive dhe me mirëbesim, të bëjnë vet deklarin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

Me respekt,

Faqe 2 nga 1